



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Tiranë, më 31.12.2020

**URDHËR**

Nr. 100, datë 31.12.2020

**“Për caktimin e tarifave të dhënies së informacionit/dokumentacionit të kërkuar”**

Bazuar në nenet 117 dhe 118, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, nenin 28, gërma “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe nenin 13 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

**URDHËROJ:**

1. Tarifa e shërbimit të dhënies së informacionit/dokumentacionit (fotokopje ose CD) nga Departamenti i Administratës Publike të jetë si më poshtë:
  - a) Deri në 10 fletë në formatin A4 apo A3, informacioni/dokumentacioni përfitohet pa pagesë nga kërkuesi/subjekti i interesuar;
  - b) Për informacionin/dokumentacionin e dhënë mbi 10 fletë në formatin A4, pagesa që duhet të paguajë kërkuesi/subjekti i interesuar pranë organit publik është 5 (pesë) lekë për fletë;
  - c) Për informacionin/dokumentacionin e dhënë mbi 10 fletë në formatin A3, pagesa që duhet të paguajë kërkuesi/subjekti i interesuar pranë organit publik është 7 (shtatë) lekë për fletë;
  - ç) Për informacionin e dhënë përmes CD-ve, pagesa që duhet të paguajë kërkuesi/subjekti i interesuar pranë organit publik është 60 (gjashtëdhjetë) lekë për CD.
2. Specialisti përkatës i sektorit, i cili do të përgatisë informacionin/dokumentacionin e kërkuar në bashkëpunim me koordinatorin për të drejtën e informimit të DAP-it, duhet të përlllogarisë koston totale të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion subjektit/kërkuesit të interesuar.
3. Me pagimin e tarifës përkatëse nga kërkuesi/subjekti i interesuar, sipas faturës së arkëtimit (të miratuar), në llogarinë e institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, menjëherë i atij i dërgohet informacioni/dokumentacioni (me postë) ose i mundësohet që t'a tërheqë atë dorazi pranë ambienteve të DAP-it.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse në DAP, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit në DAP, si dhe çdo nëpunës i institucionit që bashkëpunon me koordinatorin sipas pikës 2 të këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR DEPARTAMENTI**

**Albana Koçiu**

